



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"**

Duke u bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr. 08L/197 Për Zyrtar Publik dhe nenit 13 paragrafi 3 dhe nenit 21 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MFPT -Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 07.10.2024 nxjerrë:

V E N D I M

Kandidatja **Afrodita Gashi** për pozitën Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Administratën Qendrore të UHZ-së, në procesin e konkursit publik të datës 29.07.2024 është vlerësuar me rezultatin përfundimtar, si në vijim:

- **Vlerësimi i testimit me shkrim:** 61 pikë nga 70 pikët e parapara
- **Vlerësimi nga intervista:** 17 pikë nga 20 pikët e parapara
- **Jetëshkrimi (CV):** 10 pikë nga 10 pikët e parapara

Rezultati përfundimtar sipas kriterëve të vlerësimit: 88 nga 100 pikët e parapara

Në bazë të këtij rezultati përfundimtar, kandidatja **Afrodita Gashi** është përzgjedhur në pozitën Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Administratën Qendrore të UHZ-së, duke u renditur e para (1) në listën e rezultateve përfundimtare sipas totalit të pikëve në gjithë procesin.

Ky vendim i dërgohet nëpërmjet komunikimit elektronik kandidatës individualisht për rezultatet përkatësisht për totalin e pikëve të grumbulluara në gjithë procesin e konkursit publik për pozitën e cekur më lartë .

A r s y e t i m

Kandidatja **Afrodita Gashi**, i është nënshtruar procesit të konkursit publik të datës 29.07.2024 për pozitën Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Administratën Qendrore të UHZ-së. Pas përfundimit të procesit të konkursit Njësia e Burimeve Njerëzore ka kalkuluar pikët e grumbulluara në çdo fazë të procesit, duke rezultuar me rezultatin përfundimtar sipas kriterëve të vlerësimit të konkursit publik

Andaj duke u bazuar në të dhënat e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Njësia e Burimeve Njerëzore